

**Appendix G**  
CONTINUED ENTITLEMENT LETTER

I dashur prind/kujdestar:

Gjatë kësaj pranvere, fëmija juaj, \_\_\_\_\_, dha provimin e arritjeve në gjuhën angleze si gjuhë e dytë të shtetit të Nju Jorkut (New York State English as a Second Language Achievement Test) për të përcaktuar kompetencën e tij ose të saj në gjuhën angleze. Sipas rezultateve të provimit, fëmija juaj vazhdon që të ketë të drejtën të marrë ndihmë për zhvillimin e gjuhës angleze në klasat për nxënësit që mësojnë gjuhën angleze (English Language Learners, ELLs).

Meqenëse studimet tregojnë se nxënësit që qëndrojnë në të njëjtin program nga viti në vit kanë rezultate më të mira në provimet e anglishtes së standardizuar dhe të matematikës, si në shkallë qyteti, ashtu edhe në shkallë shteti dhe se ata janë më të suksesshëm se ata nxënës që ndërrojnë programe të ndryshme, fëmija juaj do të qëndrojë në programin ELL në të cilin ai ose ajo është regjistruar tani. (Nëse programi është një programi i Edukimit Dygjuhësor Kalimtar (Transitional Bilingual Education), fëmija do të qëndrojë në këtë program për aq kohë sa të ketë një numër të mjaftueshëm nxënësish për ta mbajtur atë program hapur).

Nëse jeni i interesuar për të ndryshuar programin e tanishëm të fëmijës, ose nëse keni ndonjë pyetje, lutemi telefononi \_\_\_\_\_ në \_\_\_\_\_. Ne presim me kënaqësi që të ndihmojmë fëmijën tuaj për të vazhduar zhvillimin e aftësive të tij ose të saj në anglisht.

Sinqerisht,

\_\_\_\_\_